

AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT

E DREJTA CIVILE, PENALE, LEGJISLACIONI TREGTAR DHE E DREJTA E PUNËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SEKSIONI I PARË: PYETJE ME ALTERNATIVA (1 PIKË SECILA)

1.Ndalimi i konkurrencës është një parim që nuk zbatohet ndaj:

- a) Ortakëve të shoqërisë kolektive;
- b) Ortakëve të kufizuar të shoqërisë komandite;
- c) Ortakëve të pakufizuar të shoqërisë komandite;
- d) Anëtarëve të këshillit të administrimit të një shoqërie aksionare

Pergjigja e sakte alternativa B

2.Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përmban dy lloje të dhënash të regjistrueshme, të dhënat e detyrueshme dhe të dhënat vullnetare. Në kuptimin e këtij ligji, shoqëritë tregtare nuk janë të detyruara të regjistrojnë:

- a) Vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;
- b) Pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e auditimit të mbajtur sipas dispozitave të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;
- d) Numrin e telefonit, faksit dhe logot e shenja të tjera dalluese për ushtrimin e veprimtarisë

Pergjigja e sakte alternativa D

3. Kalimi i kuotave në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në mënyrë që të jetë i vlefshëm duhet të bëhet me:

- a) Akt Noterial
- b) Në mënyrë të heshtur pa nevojën e një akti të shkruar
- c) Me kontratë me shkrim
- d) Formë tjetër

Pergjigja e sakte alternativa C

4. Kur konsiderohet i vlefshëm emetimi i aksioneve në njëshoqëri aksionare:

- a) Me krijimin e shoqërisë aksionare
- b) Me themelimin e shoqërisë aksionare
- c) Me regjistrimin e shoqërisë aksionare
- d) Te gjitha alternativat sëbashku

Pergjigja e sakte alternativa C

5. Caktimi i ekspertëve gjatë procesit të bashkimit të shoqërive:

- a) bëhet nga ana e asamblesë së përgjithshme;
- b) bëhet nga këshilli mbikëqyrës;
- c) bëhet nga secili përfaqësues i shoqërive ose me marrëveshje mes përfaqësuesve;
- d) bëhet nga gjykata me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë.

Pergjigja e sakte alternativa C

6. Në rastin e ndarjes së një shoqërie;

- a) atë drejtat dhe detyrimet kalojnë tek shoqëritë e përthithura;
- b) të drejtat dhe detyrimet kalojnë tek shoqëritë përthithëse;
- c) të drejtat dhe detyrimet kalojnë tek shoqëritë pritëse;
- d) të drejtat dhe detyrimet kalojnë tek a) dhe b).

Pergjigja e sakte alternativa C

7. Dorëzania është :

- a) Detyrim kryesor
- b) Detyrim plotësues
- c) Detyrim i kreditorit ndaj debitorit
- d) Detyrim i kreditorit ndaj palës së tretë

Pergjigja e sakte alternativa B

8. Nuk mund të kërkohet kryerja e orëve shtesë javore kur punëmarrësi ka kryer gjatë javës:

- a) 45 orë punë
- b) 50 orë punë
- c) 55 orë punë
- d) 60 orë punë

Pergjigja e sakte alternativa B

9. Shqyrtimi i çështjeve për procedurën e falimentimit duhet të kryhet brenda:

- a) 3 muajsh nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, seksioni tregtar;
- b) 6 muajsh nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, seksioni tregtar;
- c) një viti nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, seksioni tregtar;
- d) 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, seksioni tregtar;

Pergjigja e sakte alternativa

10. Mos njohja e ligjit që dënon veprën penale (*ignorantia legis non excusat*):

- a) nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale;
- b) përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale;
- c) përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme;
- d) nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme.

Pergjigja e sakte alternativa D

SEKSIONI I DYTË:

1. Cilat të dhëna vlerësohen si sekret tregtar dhe cilat të dhëna nuk vlerësohen sekret tregtar. Cilat janë instrumentet në dispozicion të shoqërisë, në rastin e zbulimit të informacioneve, që ajo i konsideron sekret tregtar (3 pikë)

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë. (0/5 pikë)

2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit (0.5 pikë), që lidhet me shkeljen e ligjit (0.5 pikë), apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. (0.5 pikë) Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik. (0.5 pikë)

3. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës, anëtarët e këshillit të punëmarrësve, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri. (0.5 pikë)

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet të ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes (0.5 pikë)

2. Lutem trajtoni emrat e regjistruar dhe emërtimet tregtare sipas Dispozitave të Përgjithshme të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Çfarë pasojash sjell transferimi i emrit? Në veçanti trajtoni: (5 pikë)

- Cilat janë shtojcat dhe shkurtimet që pasojnë emrat e regjistruar të a) tregtarit të vetëm, b) shoqërisë kolektive, c) shoqërisë komandime, d) shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e) shoqërisë aksionare?;
- Si përdoret emri në vijim të transferimit të veprimtarisë së tregtarit, apo shoqërisë tregtare dhe cila është përgjegjësia e atij të cilit i transferohet emri dhe shenjat dalluese të një veprimtarie?
- Çfarë pasojash prodhojnë marrëveshjet e kundërta?

Përgjigje:

Neni 5 (transferimi i emrave dhe përgjegjësisë)

Nënçështja e parë e pyetjes vlerësohet me **1 pikë**, ku kandidati duhet të japë përgjigje të saktë, si për shtojcat, ashtu dhe për shkurtimet. Pra, shtojcat dhe shkurtimet pas emrit të regjistruar janë:

Shtojca “tregtar i regjistruar”; shkurtimi “TR”

Shtojca “shoqëri kolektive”, shkurtime “SHK”

Shtojca “Shoqëri komandite”; shkurtime “SHKM”

Shtojca “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”; shkurtime “SHPK”

Shtojca “Shoqëri aksionare”; shkurtime “SHA”

Kjo nënpyetje do të vlerësohet sipas rastit me 0.1 pikë për çdo përgjigje korrekte për shtojcat dhe për shkurtime;

Nënçështja e dytë lidhet me transferimin e emrit dhe përgjegjësinë, sipas nenit 5 të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare vlerësohet me 2 pikë

Neni 5, par. 1

Personi, të cilit i transferohet veprimtaria e një tregtari ose e një shoqërie tregtare, mund të vijojë të përdorë emrin e regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë, me ose pa një shtesë, (0.4 pikë) që tregon ndërrimin e pronësisë (0.4 pikë), nëse titullari i mëparshëm i veprimtarisë apo trashëgimtarët e tij e miratojnë këtë përdorim (0.4 pikë). Nëse emri i regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë vijojnë të përdoren (0.4 pikë), titullari i ri i veprimtarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm (0.4 pikë).

Nënçështja e tretë lidhet me pasojat që prodhojnë marrëveshjet e ndryshme rregullohet nga paragrafi 3 i nenit 5 *in fine*...

Marrëveshjet, që përcaktojnë ndryshe nga sa më sipër, nuk mund t'i kundrejtohen palëve të treta (0.4 pikë), **edhe nëse janë bërë publike** (0.4 pikë) **me përjashtim të rastit kur tregtari ose shoqëria provon** (0.4 pikë) **se i tretë ka pasur dijeni për marrëveshjen** (0.4 pikë), **apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të** (0.4 pikë).

3. Regjistri tregtar ndërtohet mbi parimin e njohjes së përgjithshme të të dhënave të regjistruara, parim që kërkon publikimin e këtyre të dhënave nga organi regjistruues. Publikimi i të dhënave është një prej garancive më të rëndësishme në përmbushjen e funksioneve të Regjistrat Tregtar që lidhen me sigurinë e shkëmbimeve tregtare dhe transparencën e pjesëmarrësve në shkëmbimet tregtare. Meqenëse, ky parim është kaq i rëndësishëm për shkëmbimet tregtare, si rregullohet nga Ligji për QKR-në çështja e publikimit të të dhënave të regjistruara dhe e efekteve që publikimi i të dhënave krijon ndaj të tretëve? (5 pikë)

Përcaktoni në veçanti:

- emërtimin e e publikimit dhe mënyrën e publikimit;
- periodicitetin e publikimit;
- Kur një e dhënë e publikuar do të vlerësohet e njohur nga të tretët;
- Kur pavarësisht të publikimit të të dhënës së regjistruar, subjekti nuk mund t'ia kundrejtojë (mbrohet duke përdorur këtë argument) këtë fakt të tretëve?;

- A mundet subjekti t'iu kundrejtojë të tretëve të dhëna që janë regjistruar dhe/ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin tregtar?
- A mundet i treti t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhënat e regjistruara, apo të publikuara në mënyrë të pasaktë?
A mundet i treti t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhëna ende të papublikuara?

Pergjigje:

Neni 61 (publikimi elektronik)

Çdo e dhënë e regjistruar në regjistër nga QKR-ja publikohet **në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit** (emërtimi i publikimit – 0.5 pikë)

që mbahet nga QKR-ja **në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit** (mënyra e publikimit – 0.5 pikë)

QKR-ja kryen publikimin në buletin **brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit**. QKR-ja **për çdo ditë pune publikon në buletin të gjitha regjistrimet e kryera gjatë ditës së mëparshme** (periodiciteti –0.5 pikë)

Neni 21 (efektet e publikimit)

1. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve **nga dita e publikimit**, sipas nenit 61 të këtij ligji. (0.5 pikë).

2. Në çdo rast, të tretëve **nuk mund t'u kundrejtohen të dhënat e regjistruara dhe të publikuara** në regjistrin tregtar, **për transaksione të kryera me subjektin tregtar brenda pesëmbëdhjetë ditëve** (0.5 pikë, duhet theksuar brenda 15 ditëve, ka pak a shumë karakterin e *vacatio legis* që zbatohet për efektet e publikimit të ligjeve) **nga data e publikimit, kur i treti provon se e kishte të pamundur të merrte dijeni, duke treguar të gjithë kujdesin e zakonshëm**. (0.5 pikë, duhet theksuar se pavarësisht ushtrimit të kujdesit të zakonshëm, e kishte të pamundur të merrte dijeni).

3. Subjekti **nuk mund t'u kundrejtojë të tretëve të dhëna**, që janë regjistruar dhe/ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin tregtar. (0.5 pikë)

Gjithsesi, i treti **mund t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhënat e regjistruara e të publikuara**, edhe nëse këto të dhëna janë të pasakta, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara. (0.5 pikë)

4. I treti **mund t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhëna ende të papublikuara kur, pavarësisht mospublikimit, i treti kishte dijeni për këto të dhëna, me përjashtim të rastit kur, sipas ligjit, mospublikimi nuk sjell pasoja**. (1 pikë)

4. Si kryhet çregjistrimi i subjektit tregtar nga regjistri tregtar. Lutem përcaktoni në veçanti: (5pikë)

1. si ndodh çregjistrimi në mënyrë vullnetare për:
 - personat fizikë;
 - personat juridikë, degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja dhe shoqëritë e thjeshta;
2. çregjistrimi në rast vdekje të personit fizik;
3. çregjistrimi me vendim gjyqësor.

Pergjigje:

Neni 49 (çregjistrimi vullnetar)

Për personat fizikë çregjistrimi në mënyrë vullnetare **kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim** (0.5 pikë), i cili **mund të bëhet së bashku me njoftimin e pushimit të veprimtarisë ekonomike e tregtare ose në një çast të dytë** (0.5 pikë)

Çregjistrimi në mënyrë vullnetare për personat juridikë, degët dhe zyrat përfaqësimit të shoqërive të huaja dhe për shoqëritë e thjeshta **kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim** (0.5 pikë) dhe **depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit** (0.5 pikë), sipas legjislacionit në fuqi.

Çregjistrimi **nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë regjistrit tregtar** (0.5 pikë).

Neni 51 (i ndryshuar me ligjin nr. 8, dt. 19.02.2015)

Subjekti mund të çregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor **të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari** (1 pikë)

QKR-ja çregjistron kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës (0.5 pikë), me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit **në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte** (0.5 pikë), ose në **vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit** (0.5 pikë) apo të procedurave të tjera që mund të kërkohen sipas ligjit (0.5 pikë).

- 5. Cili është numëri minimal që duhet të ketë Këshilli Administrimit në një shoqëri aksionare me një nivel dhe cili është numëri minimal i anëtarëve duhet të ketë Këshilli i Mbikqyrjes në një shoqëri aksionare me dy nivele? (3 pikë)**

Pergjigje:

Numri minimal i Anëtarët e Këshillit të Administrimit në një shoqëri aksionare me një nivel, aashtu si dhe numri minimal i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, nuk mund të jetë më i vogël se tre

- 6. Cilat janë mënyrat e zvogëlimit të kapitalit në një shoqëri aksionare?(5 pikë)**

Pergjigje:

Shoqëria aksionare mund të zvogëlojë kapitalin e saj në disa mënyra, të cilat janë si vijon:

- Zvogëlim i zakonshëm kapitali i kryer nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve,
- Zvogëlim i thjeshtëzuar kapitali i cili realizohet për mbulimin e humbjeve si dhe transferimin e fondeve në rezerva,
- Zvogëlimi i kapitalit me anulim aksionesh,

- 7. Shpjegoni procedurën e regjistrimit dhe publikimit të rritjes së kapitalit! (4 pikë)**

Pergjigje:

Regjistrimi dhe publikimi i rritjes së kapitalit bëhet duke depozituar vendimin përkatës të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, të shoqëruar nga bilanci në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyra e fundit e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të shoqëruar nga deklarata e administratorit/ve sipas të cilit vërtetohet që gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që nëse vendimi për zmadhimin do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë QKR zmadhimi do të ishte ende i mundur. Regjistrimi i zmadhimit në QKR duhet të përcaktojë dhe nëse zmadhimi është kryer me përfshirjen e rezervave të shoqërisë apo fitimin e pashpërndarë.

- 8. Shoqëria aksionare VJOSA ka dy aksionerë A dhe B, të cilët zotërojnë kapitalin e shoqërisë në masën 50% secili. A-ja që është edhe Administrator i shoqërisë VJOSA hap një shoqëritjetër të quajtur DRINI, me të njëjtin objekt veprimtarie sikurse edhe shoqëria VJOSA. Në këtë situatë aksionerët hyjnë në konflikt me njëri tjetrin dhe si pasojë asambleja nuk funksionon rregullisht. Ndërkohë B-ja pretendon se për shkak të veprimtarisë konkurrese i janë cënuar interesat e tij si dhe të shoqërisë VJOSA. (6 pikë)**

Pyetjet që kërkojnë përgjigje:

- A mundet B-ja që të kërkojë përjashtimin e A-së?
- Cila është procedura që duhet ndjekur?
- Çfarë mund të ndodh me shoqërinë në rast mosfunksionimi të asamblesë

Pergjigje:

Përsa i përket pyetjes së parë, sqarojmë se Aksionari i një shoqëria nuk mund të përjashtohet nga shoqëria duke qenë se në ligj nuk përmban asnjë dispozitë që lejon një gjë të tillë si dhe në ligj nuk përcaktohet asnjë rast sipas të cilin një aksionar mund të përjashtohet.

Në këtë këndvështrim edhe për pyetjen e dytë themi që duke qenë se aksionari nuk mund të përjashtohet nuk ka asnjë procedurë për tu ndjekur.

Në rast së asamblea e përgjithshme nuk funksionon, që vjen si pasojë e mosrealizimit të objektit, atëherë shoqëria mund të prishet.

9. Çfarë kuptimi ligjor ka ndarja e shoqërive tregtare? Rendisni llojet kryesore të ndarjeve. (4 pikë)

Pergjigje:

Ndarja është një nga proceset e riorganizimit të shoqërive tregtare e cila synon transferimin e aktiveve dhe pasiveve nga shoqëria që ndahet drejt dy ose më shumë shoqërive të tjera. Sipas ligjit, shoqëria mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. (3 pikë)

Në varësi të faktit nëse shoqëritë pritësi janë shoqëri të krijuara rishtazi apo ekzistuese, ndarja ndahet në: ndarje duke transferuar aktivet (dhe pasivet) tek shoqëri ekzistuese ose tek shoqëri të krijuara rishtazi. (1 pikë)

Po ashtu, nëse ruhen të njëjtat raportë të pronësisë mbi kuotat/aksionet edhe tek shoqëritë pritëse, ndarja mund të jetë përpjestimore ose jo përpjesëtimore. (Duke qenë më shumë pjesë teorike, mund të mos vendosen pikë, mgjith për ata që e kanë evidentuar si kategori, mund të shtohet një pikë, pa kaluar maksimumin e pikëve të caktuara).

10. Cilat janë dy llojet e bashkimit të shoqërive tregtare të njohura nga ligji ynë? Përkufizojini me nga një fjali. (4 pikë)

Pergjigje:

Bashkimi i shoqërive tregtare realizohet si një proces riorganizimi përmes të cilit, të gjitha aktivet dhe pasive e një ose disa shoqërive transferohen tek një shoqëri tjetër. Sipas ligjit, ky proces realizohet nëpërmjet bashkimit me përthithje ose bashkimit me krijimin e një shoqërie të re. Nga pikëpamja procedurale këto bashkime janë shumë të ngjashme. Dallimi kryesor konsiston në finalizimin e këtij procesi. (2pikë)

Në bashkimin me përthithje, të gjitha aktivet dhe pasivet e njëres ose disa shoqërive (shoqëri të përthithura) transferohen tek një shoqëri tjetër ekzistuese (shoqëria përthithëse) në këmbim të kuotave/aksioneve të kësaj shoqërie. (1 pikë)

Në bashkimin me krijimin e një shoqërie të re, të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive ekzistuese, që marrin pjesën e bashkim, kalohen tek shoqëria që themelohet rishtaz, në këmbim të kuotave apo aksioneve të emetuara prej kësaj të fundit. (1 pikë)

11. Rendisni në rend kronologjik (në mënyrë të përmbledhur) procedurën e likuidimit të zakonshëm të një shoqërie tregtare. (5 pikë)

Pergjigje:

Likuidimi është procesi i përfundimit të aktivitetit tregtar i cili pason prishjen e shoqërisë tregtare. Likuidimi fillon me vendimin e asamblesë ose gjykatës (sipas rastit) për emërimin e likuiduesit të shoqërisë. (1 pikë)

Pas këtij momenti, administratori i shoqërisë njofton QKR për këtë fakt dhe depoziton pranë saj të dhënat lidhur me likuiduesin. Nga ky moment, suprimohet organi i administratorit në shoqëri dhe tagrat e tij i kalojnë likuiduesit (ose likuiduesve sipas rastit). (1 pikë)

Likuiduesi përgatit një bilanc në çastin e hapjes së procedurës së likuidimit duke identifikuar kështu kreditorët e shoqërisë, të cilët njoftohen edhe përmes ftesave të kreditorëve të cilat publikohen në QKR, dy herë me një interval prej 30 ditësh. Pasi evidenton të gjithë kreditorët e shoqërisë, likuiduesi shlyen detyrimet që shoqëria ka ndaj tyre me aktivet e saj. (1 pikë)

Nga teprica e mbetur pas shlyerjes së pretendimeve të kreditorëve zbret shpërblimin për punën e kryer prej tij dhe shpenzimet eventuale. Pjesa e mbetur shpërndahet ortakëve/aksionarëve të shoqërisë. (1 pikë)

Në përfundim të këtij procesi, likuiduesi i paraqet raportin asamblesë së përgjithshme për procedurën e ndjekur. Nëse asambleja e miraton këtë raport, atëherë vendimi i saj dërgohet në QKR dhe shoqëria çregjistrohet. (1 pikë)

12. Cilët organe njeh si përgjegjës ligji në rast të dëmeve të shkaktuara gjatë bashkimit? Si përgjigjen këto? (5 pikë)

Përgjigje:

Për çdo dëm të shkaktuar drejt ortakëve, aksionarëve dhe kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, ligji ka identifikuar organet që do të përgjigjen për këto dëme. (1 pikë)

Sipas ligjit, administratorët, anëtarët e këshillit (mbikëqyrës dhe të administrimit) të shoqërisë përthithëse do të përgjigjen bashkë me shoqërinë përthithëse për dëmet e shkaktuara ndaj subjekteve më lart. Përgjegjësisë nuk i shpëtojnë as administratorët, anëtarët e këshillit e shoqërive të përthithura si dhe ekspertët e pavarur të licencuar të fushës që janë caktuar për vlerësimin e bashkimit (2 pikë)

Kjo përgjegjësi do të jetë një përgjegjësi solidare që do të thotë, që organet dhe personat që kanë vepruar në realizimin e procedurës së bashkimit do të përgjigjen bashkërisht për të shpërblyer dëmin e shkaktuar. (1 pikë)

Përfundimisht, subjektet më sipër përjashtohen nga përgjegjësia kur provojnë se i kanë përmbushur rregullisht detyrimet ligjore të lidhura me vlerësimin e pasurive të shoqërive dhe me procedurat e përfundimit të marrëveshjes së bashkimit. (1 pikë)

13. Tagrat e së drejtës së pronësisë. (3 pikë)

Përgjigje:

Tagrat e pronarit me ate te se cilave ai realizon te drejte e pronesise jane :

- a. Posedimi - sundimi efektiv i nje personi mbi sendin **(1 pike)**
- b. Gezimi - e drejta e pronarit per ta perdorur dhe vjelur frytet e sendit **(1 pike)**
- c. Disponimi - mundesia e pronarit per te vendosur fatin e sendit **(1 pike)**

14. Mospërmbushja e detyrimeve dhe pasojat e tyre. (3 pikë)

Përgjigje:

Nje detyrim mbetet i papermbushur ne qofte se debitori nuk kryen punen, veprimi ose sherbimin qe perben objektin e detyrimit. Mospërmbushja e detyrimit mund te jete e plote ose e pjeseshme. **(1 pike)**

Cdo mangesi ne ekzekutimin e detyrimeve detyron debitorin te shperblej demin qe ka pesuar kreditori. Kreditorit i lind e drejta te ngrej padi ndaj debitorit me qellim qe : **(2 pike)**

- te kerkoj ekzekutimin ne natyre te detyrimit, dorezimin e sendit ose kryerjen e punimeve, si dhe shperblimin e demit te shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, ose

- shperblimin e demit te shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit

15. Forma e testamentit dhe kufizimet e trashëgimlënësit për të disponuar me testament. (3 pikë)

Pergjigje:

Format kryesore të berjes së testamentit të njohura nga Kodi Civil janë : **(2 pike)**

- testamenti olograf - shkruhet teresisht me dorën e testatorit, duke vënë datën dhe nënshkrimin e tij
- testamenti me akt noterial - redaktohet nga noteri pasi trashigimlënësi t'i ketë shprehur vullnetin e tij, dhe nënshkruhet nga trashigimlënësi në prani të noterit

- testamenti i posacem - kur në vende të caktuara nuk ka noter dhe testamenti vertetohet nga personat e caktuar në KC (komandanti i njesisë ushtarake, drejtori i spitalit, kapiteni i anijes etj)

Kufizimi për të disponuar me testament pasurinë është rezerva ligjore e parashikuar në KC.

Rezerva ligjore do të thotë se trashigimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashigimia me testament fëmijet e tij të mitur ose trashigimtare të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, si dhe trashigimtare të tjerë të paafte për punë. **(1 pike)**

16. Cilat janë degët në të cilat shpërndahen kontributet e paguara nga personat e punësuar që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore: (3 pikë)

Pergjigje:

Kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen në tri degë, që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore:

- a) dega e sigurimit të sëmundjeve, 0.3 përqind e shumës së listëpagesave;
- b) dega e sigurimit të barrëlindjes, 1.4 përqind e shumës së listëpagesave;
- c) dega e sigurimit të pensioneve, 21.6 përqind të shumës së listëpagesave.

17. Cilat janë pagesat që kryhen në degën e sigurimit për barrëlindje. (3 pikë)

Pergjigje:

Në degën e sigurimit për barrëlindje paguhen:

- a) përfitim për barrëlindje;
- b) përfitim për kompensimin për barrëlindje, kur ndryshohet vendi i punës;
- c) shpërblimi për lindje fëmije.

Secila prej përgjigjeve a, b dhe c ka nga 1 pikë. Referenca nëni 26 i ligjit të sigurimeve shoqërore

18. Personat që përfitojnë shpërblim për lindjen e fëmijës, kushtet dhe masa e përfitimit. (3 pikë)

Pergjigje:

Personat: Shpërblim për lindje fëmije i paguhet një personi të siguar, i cili është nëna ose babai i një fëmijë që lind

Kushtet: njëri prej tyre të ketë kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës.

Masa: Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50 përqind të pagës minimale mujore.

Secila prej fjalive vlerësohet me 1 pikë. Referenca: neni 29 i ligjit për sigurimet shoqërore

19. Cilat janë detyrat e komitetit të kreditorëve? (3 pikë)

Pergjigje:

Anëtarët e komitetit të kreditorëve duhet të mbështesin (1,5 pikë) dhe të mbikëqyrin (1,5 pikë) veprimtarinë e administratorit të falimentimit.

20. Cilët janë subjektet që legjitimohen për të kërkuar prishjen e një vendimi të marë nga mbledhja e kreditorëve? (3 pikë)

Pergjigje:

Personat që legjitimohen për të kërkuar prishjen e një vendimi të marë nga mbledhja e kreditorëve janë: një nga kreditorët e siguar të falimentimit (me të drejtë ripagimi të veçantë) (1 pikë), një nga kreditorët e falimentimit (1 pikë), ose administratori i falimentimit, në rast se kërkesa paraqitet në mbledhjen e kreditorëve (1 pikë),.

21. Kush legjitimohet për të kërkuar shkarkimin e administratorit të falimentimit? (3 pikë)

Pergjigje:

Shkarkimi i administratorit të falimentimit mund të bëhet me kërkesën e vetë administratorit të falimentimit (1 pikë), me kërkesën e komitetit të kreditorëve (1 pikë), ose të mbledhjes së kreditorëve (1 pikë).

22. Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale. (3 pikë)

Pergjigje:

Neni 21 i kodit penal të republikës së shqipërisë, sanksionon përjashtimin e autorit nga përgjegjësia penale për veprimet apo mosveprimet e tij, në kushtet e ushtrimit të një të drejte apo përmbushjes së detyrës. Më konkretisht, kjo dispozitë parashikon se nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron për të ushtruar të drejta apo përmbushur detyra të caktuara nga ligji ose nga një urdhër i dhënë prej një personi kompetent, veç rastit kur urdhri është haptazi i paligjshëm. Kur vepra penale është kryer si rezultat i urdhrimit të paligjshëm, për të përgjigjet personi që ka dhënë urdhrin dhe jo ai që ka vepruar në zbatim të urdhrimit.

Të konsiderohet si pjesë e përgjigjes edhe: kryerja e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme

dhe nevojës ekstreme.

23. Heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese. Ndaj kujt dhe në cilat raste parashikohet. (3 pikë)

Pergjigje:

Neni 40 i kodit penal të republikës së shqipërisë, parashikon heqjen e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese për ata persona, të cilët ndërsa mbajnë funksione drejtuese pranë personave juridikë, kryejnë veprime kriminale që lidhen me detyrën. Më konkretisht, bazuar në ndryshimet e bëra në këtë dispozitë me ligjin nr. 9275 të vitit 2004 (neni 6 i tij), heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë, i heq mundësinë të dënuarit të ushtrojë detyrat e drejtorit, të administratorit, sipërmarrësit, likuidatorit, si dhe çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik.

Heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale dhe jepet për një kohë nga një muaj gjer në pesë vjet, kur i dënuari ka shpërdoruar funksionet apo ka vepruar në kundërshtim me rregullat që lidhen me detyrën.

Kur dënimi i dhënë nga gjykata është jo më pak se pesë vjet burgim, kjo e drejtë mund të hiqet për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet.

24. Bazuar në konceptet dhe parimet e Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), shpjegoni në lidhje me “Instrumente të negociueshme të mbajtësit”. (3 pikë)

Pergjigje:

Bazuar në nenin 2 të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 03.03.2011), me “instrumente të negociueshme të mbajtësit” kuptohen ato urdhra të pakushtëzuar ose pretime për të paguar një shumë parash, lehtësisht të transferueshme, nga një person tek tjetri, që përmbushin disa kritere, të tilla si të jenë të nënshkruar nga bërësi ose mbajtësi i tyre, të jenë pretime të garantuara pagese ose urdhra pagese të pakushtëzuara, të jenë të pagueshëm mbajtësit apo sipas urdhrit, me t’u kërkuar apo pas një afati të caktuar kohor. Këto përfshihen, por nuk kufizohen, vetëm në çeqet, notat e premtimit, kambialet, kartat e kreditit dhe çeqet e udhëtarëve.

Suksese!